

LIRIA NGA VARFËRIA

ZVOGËLIMI I PADREJTËSIVE

MJETE TË QËNDRUESHME PËR JETESË

QASJA NË RESURSE

PARTICIPIMI

STANDARDET DINJITOZE PËR JETË

>>Çdokush . . . ka të drejtë për realizimin e të drejtave të domosdoshme ekonomike, sociale dhe kulturore, për zhvillimin e lirë të personalitetit . . . Çdokush ka të drejtë të punoj . . . Çdokush ka të drejtë për një standard jetese që siguron shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshëmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale . . . Çdokush ka të drejtë për arsimim . . . <<

NENET 22, 23, 25, 26 TË DEKLARATËS UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

TREGIMI ILUSTRUES

“Duke vdekur nga uria në Tokën e Suficitit”. Kur dështuan të mbjellat dhe nuk kishte punë, fshatarët e Mundiarit filluan të kërkojnë ushqim në xhungël. Por nuk gjetën asnjë ushqim, ata gjetën vetëm bar. Kështu, shumica e 60 familjeve e kaluan verën duke ngrënë sama – ushqim i cili përdoret zakonisht për të ushqyer bagëtinë. Por, meqenëse njerëzit nuk janë të krijuar për të ngrënë bar, fshatarët filluan shumë shpejt ta humbin shëndetin dhe u dobësuan shumë. Ata ankoheshin për shterëzim dhe plogështi. Dhe në fund, filluan edhe të vdesin. Një fshatar, Murari, shikoi tërë familjen e tij duke vdekur ngadalë. Fillimisht vdiq babai i tij Ganpati, e pastaj edhe gruaja e tij Bordi. Katër ditë më vonë, ai humbi edhe vajzën e tij. Në këtë pjesë të Indinë së brendshme veriore, e cila dikur ishte e mbuluar nga pyjet e gjelbra, kurse tani e mbuluar nga thatësia, tregimi është i njëjtë. Gjatë dy mujave të kaluar, më shumë 40 persona të fisit Saharija (Sahariya) kanë vdekur nga uria. Afër 60 milion tonë grurë të tepërt, është duke u mbajtur në depot e qeverisë. Sipas çfarëdo standardi, kjo tepëri paraqet një mal të madh me ushqim. Për fat të keq, aspak nga kjo sasi e tepërcave nuk arriti në fshatin Mundiari, ose në ndonjë fshat tjerë të largët në pjesët e thella të Rajasthanit juglindor.

Zyrtarisht, në Indi askush nuk vdes nga uria. Sipas sistemit publik për distribuimin e ushqimit, fshatarët që gjenden nën nivelin e caktuar të varfërisë, kanë të drejtë për kartelat ushqimore, të cilat u mundësojnë atyre blerjen e drithërave të subvencionura, nëpër dyqanet shtetërore. Por, në Bhojal dhe vendet tjera ky sistem ka dështuar. Sarapanqi lokal (udhëheqësi i fshatit), ashtu siç treguan fshatarët, ua ka shpërndarë kartelat e ushqimit të gjithë miqve dhe pjesëtarëve të fisit të tij. Ai, po ashtu ka shënuar emrat e të gjitha vejushave që kanë të drejtë për pension shtetëror. Kurse, në anën tjetër, pronarët e dyqaneve shtetërore refuzuan t'ua shesin drithërat e lira sahariasve të largët dhe i shitën ato në tregun e zi. Kur saharijasit filluan të vdesin, pronarët e dyqaneve i plotësuan kartelat e tyre, duke u munduar ta mbulojnë marrinë e bërëe. Niveli i ushqimit të pamjaftueshëm në Indi – shtet me më shumë se 1 bilion njerëz – është ndër më të lartit në botë. Përafërsisht, gjysma e fëmijëve të Indisë marrin ushqim të pamjaftueshëm, derisa 50% e grave të Indisë vuajnë nga anemia. Por megjithëkëtë, shumica e drithërave të tepërta të Indisë ose hidhen ose atë e hanë minjtë. Në Indi, më së shumti vuajnë ata të cilët gjenden në fund të sistemit hierarkik të kastave. Gjithashtu, komunitet fisnore që përbëjnë afër 30% të popullsisë së distriktit të Baranit (Baran), janë viktimat e padrejtësisë historike. Para pavarësisë së vitit 1947, saharijasit kanë mbijetuar nga gjuetia dhe rritja e bagëtive. Pas pavarësisë, zyrtarët i larguan ata nga xhungla dhe e konfiskuan tokën e tyre. Saharijasit janë detyruar të kërkojnë punë si bujq. Kur të mbjellat dështuan këtë verë, ata nuk patën punë, kështu që nuk patën as ushqim për të ngrënë.

Një grua 50 vjeçare e cila përgatiste darkën e saj prej samas – farë e barit të egër, tha: “Politikanët nuk janë të interesuar për ne”.

BURIMI:

PJESË NGA “DYING OF HUNGER IN A LAND OF SURPLUS. CASTE AND CORRUPTION CONNIVE TO KEEP FOOD FROM INDIA’S POOR”, LUKE HARDING IN BARAN, RAJASANTHAN. FRIDAY 15 NOVEMBER 2002. THE GUARDIAN.

PYETJET PËR DISKUTIM



1. Cilat deprivime dhe nënshtrime i kanë përjetuar të varfërit në Baran? Si i vlerësoni këto, “*Shkelje e të drejtës për . . .*”
2. Çfarë kujtimi zgjon te ju kjo përvojë dhe çka mendoni se duhet bërë?
3. Krahaso gjendjen e varfërisë në Baran me përvojat e varfërisë në vendin tuaj. Sipas përvojës që keni, çfarë janë përfytyrimet tuaja për varfërinë?
4. A e vëreni ndonjë lidhje në mes të rritjes së varfërisë dhe sigurisë njerëzore? A mendoni se trajtimi i njerëzve ashtu siç është përshkruar në tregimin ilustrues mund të ndikojë në sigurinë njerëzore? Nëse po, çfarë efektsh mund të ketë?

E DOMOSDOSHME TË DIHET

1. HYRJE

Edhe pse varfëria shikohet si një fenomen historik, format në të cilat ajo po shfaqet sot e bëjnë atë dukshëm më komplekse. Ky kompleksitet është rezultat i shumë faktorëve, përfshirë këtu edhe ndërrimin e natyrës së marrëdhënieve ndërmjet njerëzve, raporteve të shoqërisë me faktorët dhe proceset e prodhimit, si dhe perspektivën e qeverive dhe institucioneve ndërkombëtare, siç janë Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar ose Kombet e Bashkuara, lidhur me dimensionet e ndryshme të varfërisë.

Koncepti i varfërisë është zhvilluar gjatë kalimit të kohës. Varfëria, e cila më parë është parë vetëm në kontekstin e të ardhurave, tani shihet si koncept multidimensional, i cili rrjedh dhe është i lidhur ngushtë me politikën, gjeografinë, historinë, kulturën dhe veçoritë sociale. Në shtetet në zhvillim, varfëria është majft e përhapur dhe karakterizohet me uri, mungesë të tokës dhe burimeve të mjaftueshme për jetë, politika joefektive të redistribuimit, papunësi, analfabetizëm, epidemi, mungesë të shërbimeve mjekësore dhe mungesë të ujit të mjaftueshëm. Në vendet e zhvilluara, varfëria manifestohet përmes përjashtimeve shoqërore, rritjes së papunësisë dhe pagesës së ulët. Në të dyja rastet, varfëria ekziston për shkak të mungesës së drejtësisë, barazisë, sigurisë njerëzore dhe paqes.

Varfëria nënkupton pamundësinë e qasjes në botën e mundësive të mjaftueshme. Si pasojë e mungesës së lirisë politike, pamundësisë për pjesëmarrje në proceset e vendimmarrjes, mungesës së qeverisjes së mirë, mungesës së sigurisë personale,

pamundësisë për pjesëmarrje në jetën e komunitetit dhe kërcënimeve për drejtësi të qëndrueshme afatgjatë, të varfërit nuk kanë mundësi ta ndryshojnë gjendjen e tyre, sepse u mohohen mjetet për mundësi të tilla. **Mohimi i fuqisë dhe i resurseve ekonomike, sociale dhe kulturore**, janë ato që i mbajnë të varfërit të zhytur në varfëri.

Varfëria dhe siguria njerëzore

Varfëria e cila shkakton pasiguritë e mëdha ushqimore dhe shoqërore, është një ndërhyrje direkte në sigurinë njerëzore. Varfëria, jo vetëm që kërcënon ekzistencën e një numri të madh të njerëzve, por e shton nënshtrimin e tyre ndaj dhunës, keqtrajtimit dhe pandikueshmërisë sociale, politike dhe ekonomike. Ashtu siç tha një grua në Bellorusi, varfëria është poshtëruese dhe e ul dinjitetin e çdo personi. Profesor Amartia Sen (Amartya Sen), duke potencuar nevojën për shikimin e sfidave të barazisë globale dhe sigurisë njerëzore, në një mënyrë disi të ndryshme theksoi se *“detyra urgjente janë, sqarimet konceptuale dhe promovimi i diskutimeve publike si plotësim ndaj identifikimit të projekteve konkrete për promovimin e drejtësisë dhe për garantimin e sigurisë themelore të njerëzve. Me hulumtimin e kërkesave për shëndetësi, arsimim, mënjanimin të varfërisë, zvogëlim të pabarazive gjinore dhe të pasigurisë, duhet të integrohet një kuptim më i plotë mbi konfliktet dhe vlerat.”*

Prandaj, varfëria paraqet edhe akt të deprivimit edhe të nënshtrimit. Si rrjedhojë e rritjes së pabarazisë dhe diskriminimit mes kombeve dhe diskriminimit brenda një kombi, bëhet shkelja e së drejtës së të varfërve për të jetuar në siguri dhe me dinjitet.

2. DEFINIMI DHE PËRSHKRIMI I ÇËSHTIES



Definimi i varfërisë

Ekzistojnë definicione të ndryshme për varfërinë dhe shfaqjen e saj:

- Nga perspektiva e të ardhurave, varfëria e definon personin si të varfër nëse dhe vetëm nëse niveli i të ardhurave të tij/saj është nën nivelin e caktuar të varfërisë. Shumë shtete kanë caktuar nivelin minimal të pagave për ta mbikëqyrur përparimin në uljen e varfërisë. Kufiri është tërhequr te të ardhurat e mjaftueshme për një sasi të caktuar të ushqimit. Në bazë të **Raportit për Zhvillim Njerëzor të UNDP** të vitit 1997 *“varfëria nënkupton mohimin ndaj mundësive dhe zgjidhjeve themelore për*

zhvillim njerëzor, pra për të bërë jetë të shëndoshë, dhe kreative, për të gëzuar standarde dinjitoze për jetë, liri, dinjitet, vetërespekt dhe respekt për të tjerët.”

- **Indeksi i varfërisë njerëzore** (UNDP, HDR 1997), si rezultat i përdorimit të indikatorëve më themelor të deprivimit, siç janë jeta e shkurtër, mungesa e arsimit elementar dhe mungesa e qasjes në resurse publike dhe private, e njeh varfërinë e njerëzimit më gjerë se vetëm si varfëri në të ardhura.
- Nga perspektiva e të drejtave të njeriut, **Zyra e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut**, e sheh varfërinë si *“një gjendje njerëzore e karakterizuar nga deprivimi i vazhdueshëm ose kronik ndaj resurseve, mundësive, zgjidhjeve, sigurisë, fuqia e nevojshme për gëzimin e një standardi adekuat për jetesë dhe nga të drejtat fundamentale civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale.”*
- Sipas **draftit udhëzues: Qasja e të Drejtave të Njeriut në Strategjitë për Uljen e Varfërisë**, të Zyrës së Komisionerit për të Drejtat e Njeriut, nga shtatori i vitit 2002, varfëria shihet si një *“formë ekstreme e deprivimit”*. Raporti sugjeron se vetëm dështimet ndaj atyre mundësive, që sipas një prioritetit konsiderohen themelore, duhet të numërohen si varfëri. Deri sa këto mund të ndryshojnë nga një shoqëri në tjetrën, për shumicën e shoqërive, tërësia e kërkesave themelore të përbashkëta përfshin, nevojën për ushqyeshmëri të mjaftueshme, ndalim të vdekjeve në ato raste kur është e mundur, vdekjeve të hershme, nevojën për strehim adekuat, arsimim elementar, garantim të sigurisë personale, garantim të qasjes së barabartë ndaj drejtësisë, shfaqjes në publik pa turp, mundësi për të fituar të mira për jetë dhe pjesëmarrje në komunitet.

Debatet lidhur me mënyrat e matjes dhe shënimit të varfërisë ende vazhdojnë, por kompleksiteti i jetës njerëzore lë të kuptohet se varfëria gjithmonë do të jetë në kërkim të një definicioni. Duke qenë se nënshtrimi dhe deprivimi, kryesisht janë subjektive, nuk mund të përmbliken në kuadër të një strukture të ngurtë dhe të aplikueshme universalisht.

Dimensionet e varfërisë. Varësisht nga konteksti specifik ekonomik, social, kulturor dhe politik, fenomeni i varfërisë kuptohet dhe artikullohet ndryshe. Me qëllim që të ndihmohet shpjegimi i dimensioneve të ndryshme të varfërisë, duhet bërë një hap përpara dhe të

bëhet përpjekje që fjalët e përfshira në definicionin e varfërisë (si p.sh. drejtësia, nënshtrimi, dinjiteti, siguria, mundësitë etj) t'i ndërlidhim me jetën reale.

Mjetet për jetë – Në viset rurale, ku ligjet e shtetit për pyje nuk e lejojnë popullsinë autoktone të mbledhë ushqim për vete dhe bagëti, që përndryshe u takon, kjo nënkupton mohimin e qasjes në tokë, pyje dhe ujë. Në kotekstin urban, p.sh. qyteti dëshiron ta shfrytëzojë fuqinë punëtore të migrantëve nga viset rurale, por nuk merr përgjegjësi për nevojat e tyre për strehim, arsimim dhe shëndet, duke i shtyrë kështu edhe më shumë kah pasiguria dhe nënshtrimi më i madh. Diskriminimet e bazuara në kasta, etnicitet ose racë, gjithashtu kanë qenë faktorë të rëndësishëm për ndalimin e komuniteteve ose grupeve të caktuara që të kenë qasje ndaj resurseve natyrore elementare dhe me këtë edhe ndaj drejtës për jetë dinjitoze.

Nevojat elementare – Nëse komercializimi i ujit, energjisë elektrike, shkollës dhe shërbimeve shëndetësore, si shërbime elementare shkakton çmime përtej mundësisë së të varfërve, duke i detyruar ata t'i shesin të mirat e kursyera dhe për të jetuar nën nivel njerëzor, kjo nënkupton mohimin e ushqimit, arsimimit dhe kushteve normale për jetë dhe banim, që **menjëherë i privon ata të jetojnë me dinjitet.**

Drejtësia – Mohimi i drejtësisë *per se* ose drejtësisë në një kohë të caktuar, është si p.sh. rasti i të varfërve në shumë shtete, ku nuk kanë qasje në sistemin gjyqësor për arsyë të kostos së lartë. Zakonisht, të rinjtë e lagjeve të varfëra, minoritetet etnike, racore dhe fetare, janë të parët të cilët dyshohen për krime që nuk i kanë bërë, ndërsa gratë të cilat kërkojnë ndërhyrjen e policisë në rastet e dhunës familjare, shpërfillen me pretekstin se ato janë çështje private. Shpesh, si rrjedhojë e presionit nga shteti ose nga lobistët e fortë, gjykatat janë vërejtur duke zgjatur zgjedhjen e çështjeve të kompensimit të punëtoëve ose rehabilitimit të personave të zhvendosur, e që të varfërve u kushton me të gjitha të mirat që i kanë.

Organizimi – Nëse varfëria ndërhyr në lirinë e punëtorëve për t'u organizuar me qëllim të përmirësimit të kushteve të tyre të punës, atëherë kemi mohim të së drejtës për t'u organizuar, për të kërkuar pushtet dhe për të rezistuar padrejtësinë.

Pjesëmarrja – Mohimi i së drejtës për pjesëmarrje dhe ndikim në vendimet që prekin jetën, ndodh në raste siç janë p.sh. rritja e interesave politike dhe interesave të kompanive për ngushtimin e hapësirës së qytetarëve për pjesëmarrje efektive në çështjet publike sikurse është ofrimi i shërbimeve themelore. Analfabetizmi dhe mungesa e informatave si rezultat i zhvendosjes së refugjatëve, ua mohon atyre të drejtën për përcaktimin e ardhmërisë së tyre. Shumica e romëve, për shkak të natyrës së tyre migruese, në të shumën e rasteve nuk shënohen në listat e votuesve dhe për këtë arsye fare nuk mund të votojnë.

Dinjteti njerëzor – Për shembull, në viset rurale, pjesëtarët e kastave, minoriteteve etnike, racore dhe grupeve tjera, që e formojnë pjesën më të madhe të njerëzve të patokë ose pronarëve të parcelave të vogla, janë të detyruar të bëjnë kompromis me dinjtetin e tyre për të fituar paga minimale, që nënkupton se u mohohet e drejta për të jetuar me respekt dhe dinjtet. Fëmijët, në vend se të jenë në shkollë, janë të detyruar për punë eksploatuese siç është reciklimi i mbeturinave, qepja e lëkurës ose agrikultura.



Grupet e prekura nga varfëria

Edhe pse varfëria është një fenomen shumë i përhapur dhe prek njerëzit në mbarë botën, ajo në veçanti është akute për gratë dhe fëmijët.

Si rezultat i rritjes së migrimit të meshkujve, papunësisë dhe shtimit të pronarëve të ekonomive të orientuara kah eksporti për të cilat shpërblehen pak, **feminizimi** i varfërisë është bërë një problem i madh në vendet me ekonomi në tranzicion. Pjesa më e madhe e punës së grave mbetet e pashënuar dhe e papaguar. Në sektorin e ekonomisë, meshkujt preferohen më shumë se gratë, pasi që ato konsiderohen si ‘fuqi e butë punëtore’. Në shumë shoqëri gratë nuk posedojnë dhe nuk kanë mbikëqyrje mbi tokën, ujin, pronën dhe resurset tjera, kështu që ato përballen me barriera të mëdha sociale dhe kulturore në realizimin e të drejtave të tyre. 🙋🏻 Moduli për të Drejtat e Grave

Varfëria ua mohon fëmijëve mundësitë për realizimin e potencialit të tyre si qenie njerëzore dhe i bën të nënshtuar ndaj dhunës, trafikimit, eksploatimit dhe abuzimit.

Shkalla e lartë e vdekjes së të rinjve dhe të të miturve është shkak i ushqyeshmërisë së pamjaftueshme; ndërsa raporti i lartë i përpjesëtimit fëmijë – i rritur është një arsye plotësuese për varfëri në të ardhura. Me rritjen rapide të urbanizimit, po rritet vazhdimisht edhe numri i fëmijëve që jetojnë në rrugë. Afër 113 milion fëmijë nga e gjithë bota (97% e të cilëve ndodhen në vendet në zhvillim) nuk kanë shkuar kurrë në shkollë dhe paraqesin gjah të lehtë për nënshtrim ndaj formave të ndryshme të eksploatimit ose punës. Për më tepër, komercializimit i arsimit dhe shërbimeve shëndetësore, fëmijëve të shumë vendeve është duke ua mohuar të drejtat e tyre kushtetuese.



Pse varfëria po vazhdon?

Qeveritë veriore të cilat e kontrollojnë udhëheqjen e ekonomisë botërore, janë të vendosura të mbajnë tregtinë dhe strukturat financiare që sjellin pasurinë në botën e industrializuar dhe të përjashtojnë vendet dhe popujt e varfër nga shpërndarja e prosperitetit global, gjendje kjo e cila rezulton me pabarazi mes Veriut dhe Jugut. Është mjaft interesant fakti se, si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në ato në zhvillim, dallimi mes të pasurve dhe të varfërve është rritur.

Programet e Bankës Botërore për Rregullimin e Strukturës (SAPs) dhe pakot e Fondit Monetar Ndërkombëtar për stabilizim, erdhën si premtime për zgjerim, rritje të mundësive të punësimit, paga, pasuri dhe zhvillim ekonomik, për ato kombe që synojnë integrimin në sistemin e ekonomisë globale. SAPs i cili tenton të zhdukë varfërinë përmes disiplinës fiskale dhe duke mos i shqyrtuar padrejtësitë në kuadër të sistemit të shpërndarjes, mund ta intensifikojë varfërinë edhe më shumë, pasi që shtetet, duke shpenzuar para për shlyerjen e borxheve, janë duke e neglizhuar nevojën për shpenzime në shërbimet elementare, siç janë, shëndetësia, arsimi dhe strehimi.

Globalizimi neoliberal e vendos përqendrimin te prodhimtaria për eksport, duke injoruar të drejtat elementare të njerëzve për plotësimin e nevojave vetanake dhe realizimin e të mirave për jetë në mënyrë të denjë. Shmangia e shtetit nga përgjegjësitë që ka, lidhur me mirëqenien për shëndet, arsim, ushqim dhe strehim, si dhe mungesa e të ardhurave të sigurta, e bëjnë edhe më të madh presionin mbi të varfërit. Gjithashtu, të varfërit i ka

dëmtuar edhe inflacioni, kontraktimi i punësimit dhe erozioni i pagave reale nga liberalizmi, si dhe privatizmi i pasurive.

Raporti i UNDP i vitit 2002 për Zhvillimin Njerëzor, thekson se gjatë pjesës së dytë të shekullit XX, rritja e shpejtë ekonomike në vendet tashmë të pasura të Evropës Perendimore, Amerikës Veriore dhe Oqeanisë, në kombinim me rritjen e ngadalshme ekonomike të subkontinetit Indian dhe zhvillimin tejet të ngadalshëm të Afrikës, kanë kontribuar edhe më shumë për **rritjen e pabarazisë globale**. Edhe në vendet e OECD-së (Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillimi Ekonomik), përfitimet janë realizuar nga më të pasurit, nga 1% e familjeve me të ardhura të rritura prej 140%, ose tri herë më shumë se mesatarja, duke shtuar kështu në mënyrë drastike pabarazinë në të ardhura dhe duke prodhuar të “*varfër të ri*”.

- 5% të njerëzve më të pasur të botës kanë të ardhura 114 herë më të mëdha se 5% e më të varfërve.
- Të ardhurat e 25 milion amerikanëve më të pasur, janë të barabarta me të ardhurat e afër 2 bilion njerëzve më të varfër të botës.

Sot, një e katërta e popullatës botërore jetojnë në varfëri të rëndë dhe të izoluar nga shoqëria. Në bazë të raportit të UNDP të vitit 2002 për Zhvillim Njerëzor, diku rreth 1.2 bilion njerëz mbijetojnë me më pak se \$1 në ditë. Një bilion njerëz janë analfabetë. Çdo ditë, rreth 30.000 fëmijë në botë vdesin nga sëmundjet që janë të shërueshme dhe deri në fund të vitit 2000, afër 22 milion njerëz kanë vdekur nga AIDS-i. Derisa afër 1/3 e popullsisë së vendeve të pazhvilluara, shumica e të cilëve ndodhen në pjesën e poshtme të Saharës së Afrikës, nuk pritet t’i mbërrijnë të dyzetat.



PERSPEKTIVAT NDËRKULTURORE DHE ÇËSHTJET

KONTRAVERSE

Varfëria relative dhe varfëria absolute

Varfëria relative tregon që një person ose një grup personash janë të varfër në krahasim me të tjerët, ose në krahasim me atë që konsiderohet të jetë standard i drejtë për jetesë, ose nivelin e konsumimit në një shoqëri të caktuar. *Varfëria absolute* tregon që njerëzit janë të varfër në krahasim me atë që konsiderohet të jetë standard i kërkesave minimale.

Një person i cili sipas standardeve amerikane konsiderohet i varfër absolut, sipas standardeve të themi të Afrikës, mund të konsiderohet i varfër relativ.

Xhim Harvej (Jim Harvey), banor i Posilparkut (Possilpark) të Britanisë së Madhe, flet për përvojën e tij me varfërinë, e cila mund të cilësohet si varfëri relative: *Varfëria! Çka do të thotë kjo për mua? Kështu, unë jam 48 vjeçar, i martuar, me familje dhe pa fëmijë. Jetoj në Posilpark, që gjendet në veri të Glasgout (Glasgow). Pa dyshim se unë i takoj klasës punëtore. Por, këtu mund të ketë pak dyshim, pasi që tani për disa vite me radhë kam qenë i papunësuar dhe maksimalisht i varur nga beneficionet. Atëherë, çka është varfëria? Për mua kjo do të thotë të jesh 'pa para në xhep'. Po ashtu, do të thotë të mos kesh mundësi ta përmirësosh stilin e jetës si pasojë e dietës së dobët dhe pamundësisë për të marrë pjesë në aktivitete të lira. Gjithashtu, ekziston edhe njolla sipas të cilës varfëria vetëm shtohet. Aty është edhe apatia e ndjenjës së pafuqisë, shtypjes, ndjenjës së pavlefshmërisë, përjashtimit, . . . pse? Pse unë? . . .”*

BURIMI: LOTHIAN ANTI POVERTY ALLIANCE, [HTTP://WWW.LAPA.ORG.UK](http://www.lapa.org.uk)

Edhe pse nevojat elementare ekonomike të Xhimit janë të siguruara, ai përjeton përjashtimin dhe stagnimin, gjë që e bën atë të palumtur me pafuqinë të cilën e ndien dhe mbijetesën e tij minimale. Kjo, në të vërtetë, tregon se Xhimi është relativisht i varfër, në krahasim me të tjerët e shoqërisë së tij, që janë shoqërisht dhe politikisht aktivë.

Përrjashtimi shoqëror. Edhe pse përrjashtimi shoqëror, shpesh përdoret si sinonim me ‘varfërinë relative’, këto konceptet nuk janë identike. Përrjashtimi shoqëror mund të çojë drejt varfërisë, por, në të njëjtën kohë, përrjashtimi shoqëror mund të vijë si pasojë e varfërisë. Në rastin e Xhimit, përrjashtimi shoqëror ka shkaktuar pushimin e ekzistimit të tij politik, deri sa në rastin e komunitetit Saharias të Raxhastanit (Rajasthan), varfëria e tyre ekonomike dhe skamja, kanë qenë instrumente të përrjashtimit të tyre nga shoqëria.

PYETJET PËR DISKUTIM 

A nënkupton rritja e popullsisë automatikisht edhe varfëri më të madhe? Është besim i përgjithshëm se shtimi i lartë i popullsisë në vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim, është përgjegjës për përhapjen e varfërisë në këto vende. Kjo argumentohet nga disa

qeveri të Jugut dhe Veriut, me qëllim të tërheqjes së vëmendjes nga çështjet qendrore, të cilat janë burime kryesore të varfërisë në këto shtete. Këto çështje qendrore janë, shtrydhja dhe eksploatimi i vazhdueshmë i resurseve natyrore nga shtetet e zhvilluar për interesa komerciale, që rezultojnë me zhveshjen e këtyre komuniteteve nga e drejta për resurse; mungesa e ndarjes së fondeve për shërbime elementare, siç janë arsimi, shëndetësia dhe uji, të cilat në mënyrë të dukshme do të zvogëlonin mortalitetin dhe sëmundjet e fëmijëve dhe të grave; si dhe shtimi i konflikteve dhe luftërave për përfitimin e kontrollit mbi resurse, që rezultojnë në jostabilitet politik, shoqëror dhe ekonomik.

Argumenti sipas të cilit numri i madh i të varfërve në një vend është pengesë për përparimin e atij kombi është i pavlefshëm, kurse në të vërtetë përgjegjëse janë shumë qeveri, të cilat me politikën e shpërndarjes së fitimeve për zhvillim bëjnë alokimin e këtyre mjeteve në mënyrë të padrejtë. Prandaj, mendimi sipas të cilit të varfërit janë përgjegjës për konsumim të resurseve natyrore dhe degradim të mjedisit nuk qëndron, pasi që, në të vërtetë, të pasurit kanë nivel më të lartë të konsumit se sa të varfërit.

A do të çojë zhvillimi i qëndrueshëm drejt uljes së varfërisë? Varfëria i detyron të varfërit të zgjedhin mënyrat e paqëndrueshme për jetesë. Për shembull, mungesa e shërbimeve higjienike dhe sistemeve për asgjësim të mbeturinave, sikurse edhe mungesa e derivateve, mund t'i detyrojë të varfërit të përdorin metoda të cilat i kontribuojnë degradimit të mjedisit. Zhvillimi i qëndrueshëm, që do të rezultonte në zvogëlimin e qëndrueshëm të varfërisë do të arrihet vetëm atëherë kur shtetet e zhvilluara vendosin t'i respektojnë obligimet e marra, siç janë, zvogëlimi i emetimit të gasit i cili ngroh atmosferën përmes realizimit të standardit të energjisë efektive dhe kur fillojnë të paguajnë taksat e transaksionit për lëvizjen e kapitalit përtej kufijve, etj.

A është e mundur të financohet çrrënjësia e varfërisë? Po, është e mundur. Është llogaritur se në shtetet e zhvilluar, nevojiten afër 40 bilion dollarë amerikanë në vit, si shpenzime plotësuese, për t'u ofruar shërbime elementare të gjithëve, të cilat përfaqësojnë paraqesin 1/8 e buxhetit të mbrojtjes të SHBA-ve për vitin 2001/02, ose 8 bilion dollarë më pak sesa të ardhurat neto të njeriut më të pasur për vitin 2001/02. Po ashtu, shumica e këtyre parave do të mund të realizohej përmes riorganizimit të shpenzimeve nga ana e

qeverive, bankave multilaterale (Bankës Botërore, Bankës së Zhvillimit Aziatik etj) dhe organizatave të tjera humanitare. Financimi i çrrënjosjes së varfërisë do të ishte shumë më i lehtë sikur institucionet ndërkombëtare siç janë, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe qeveritë anëtare të OECD, të vendosnin të heqin dorë nga borxhet e ekzistuese të disa qeverive ndaj disa përkushtimeve që kanë, dhe varësisht nga kërkesat e shoqërisë lokale, t'i orientojnë ato fonde në çrrënjosjen e varfërisë.

Shpenzimet e llogaritura do të zvogëloheshin edhe më shumë, sikur shtetet konkrete të vendosnin për të ndërmarrë reforma radikale në fushën e shpërndarjes së pasurisë dhe resurseve, dhe nëse vendosin t'u japin prioritet më të lartë shpenzimeve për zhvillim sesa shpenzimeve për mbrojtje.

4. ZBATIMI DHE MONITORIMI

Globalizimi dhe pasojat e tij kontraverse janë duke prodhuar forma të reja të varfërisë. Për më tepër, këto forma të reja janë duke u shfaqur nëpër shoqëri të niveleve të ndryshme të zhvillimit shoqëror-politik dhe ekonomik dhe duke përfshirë njerëz të besimeve, religjioneve dhe kulturave të ndryshme. Për shembull, ndikimi i globalizmit në fiset e Afrikës është i ndryshëm nga ato të Indisë, kryesisht për shkak të kushteve të ndryshme shoqërore-politike dhe ekonomike që janë në Afrikë, në krahasim me ato në Indi. Këto dallime të dukshme mes kulturave dhe regjioneve të ndryshme gjeografike, gjithashtu kanë ndikuar në mënyrën e perceptimit të njerëzve ndaj kërcënimeve nga varfëria dhe marginalizimi i shoqërisë.

Prandaj, është shumë e rëndësishme të vazhdohet zhvillimi i mëtejshëm i **strukturës për monitorimin e këtyre formave të varfërisë**, si në nivelin global, ashtu edhe në atë lokal, si dhe të aftësohen njerëzit për ta forcuar resistencën dhe luftën e tyre kundër forcave eksploatuese.

Karta e OKB-së dhe Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, kanë pasur qëllim që pas Luftës së Dytë Botërore të ofrojë për të gjithë njerëzit një kornizë morale për ndërtimin e një sistemi të ri të drejtave dhe detyrimeve dhe duke i dhënë rëndësinë më të madhe garantimit të dinjitetit njerëzor, paqes dhe sigurisë njerëzore.

Pikërisht, qasja ndaj të drejtave të njeriut si të pacenueshme është ajo që mundëson përgjigjen ndaj natyrës multidimensionale të varfërisë. Kjo qasje tejkalon lëmoshën duke pranuar se, liria nga varfëria është e mundur vetëm atëherë ku të varfërit **aftësohen përmes arsimimit në të drejtat e njeriut**. Kjo qasje vërteton se të **varfërit** kanë të drejta ligjore, kurse shteti dhe strukturat joshtetërore kanë obligim ligjor t'i përmbushin ato. Duke vendosur përgjegjësinë mbi shtetet për realizimin e të drejtave të gjithë personave që jetojnë brenda juridiksionit të tyre, strukturat e tjera shtetërore dhe joshtetëore kanë obligim të kontribuojnë dhe ta përkrahin këtë proces. Kjo është e rëndësishme esenciale për të krijuar një sistem afarist multilateral, të drejtë, të barabartë dhe joproteksionist, për të realizuar ndarjen adekuate të asistencës financiare dhe sigurimin e ndikimit të të varfërve në procesin zhvillimor të kësaj bote të globalizuar. Këto **vlera** gjejnë vend në deklaratat politike siç janë Deklarata e Rios, Agjenda 21, Deklarata e Kopenhagës, Platforma e Pekinit për Veprim dhe Agjenda e Habitatit, të përpiluara nga shtetet e ndryshme si plan zhvillimor për çrrënjosjen e varfërisë dhe si kërkesa të domosdoshme për zhvillim të qëndrueshëm.



Organet e Konventave ndërkombëtare për monitorimin e varfërisë

Me qëllim të përmirësimit të dosjeve të të drejtave të njeriut dhe zbutjes së varfërisë, trupat monitoruese brenda intervaleve të caktuara kohore bëjnë ekzaminimin e rregullt të raporteve shtetërore, mund të pranojnë ankesa, t'u japin vërejtje dhe rekomandime shteteve, institucioneve ekonomike, organizatave të OKB dhe të tjerëve.

Vërejtjet përfundimtare të Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore mbi raportet e disa shteteve anëtare tregojnë se, si faktorë vështirësues paraqiten, mungesa e sqarimeve mbi statusin e Konventës në legjislacionet vendore, mungesa e zbatimit të ligjeve të bazuara në të drejtën ndërkombëtare dhe informatat e pamjaftueshme mbi instrumentet e konventave. Raportet theksojnë se pengesat kryesore që paraqiten në implementimin e strategjive për uljen e varfërisë janë, borxhet ekzistuese, mungesa e shënimeve të sakta, korrupsioni i përhapur tek autoritetet shtetërore, regjimet ushtarake që rrezikojnë gjyqësinë dhe ndikimet konservative religjioze që imponojnë diskriminimin.

Edh pse pas viteve të '90-ta numri i shteteve që kanë ratifikuar konventat e ndryshme për të drejtat e njeriut është rritur në mënyrë drastike, ekziston një zbrastësi e madhe ndërmjet zotimeve, qëllimeve politike dhe implementimit faktik të tyre. Mungesa e vullnetit politik të qeverive dhe zotimet konfliktuoze të bëra ndaj platformave ndërkombëtare, siç është ajo e WTO (si p.sh. TRIPS-i, i cili do të mund të rezultojë në ngritjen e shpenzimeve të medikamenteve dhe kënaqjen e lakmive të kompanive, duke ua mohuar individëve të drejtën e tyre elementare për jetë të shëndoshë dhe dinjitoze) dhe shpërndarja joadekuate e resurseve, janë kërcënimet kryesore për realizimin e zotimeve të marra.



Raportuesit special dhe ekspertët e pavarur

Komisioni për të Drejtat e Njeriut ka emëruar dy ekspertë të pavarur, prej të cilëve njëri ka mandat për t'i raportuar grupit special punues lidhur me implemetimin e së drejtës për zhvillim (Rezoluta 1998/72), deri sa tjetri ka obligim të bëjë hulumtime dhe rekomandime lidhur me ndikimin e varfërisë ekstreme në të drejtat e njeriut (Rezoluta 1998/25). **Eksperti i Pavarur për Varfërinë Ekstreme**, bën vlerësimin e masave të cilat ndërmerren në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për promovuar gëzimin e plotë të drejtave të njeriut nga personat që jetojnë në varfëri ekstreme, bën vlerësimin e pengesave dhe përparimin e bërë të grave dhe burrave që jetojnë në varfëri ekstreme, dhe gjithashtu në kuadër të fushës së asistencës teknike dhe të tjera, bën rekomandime dhe propozime për uljen ose eventualisht eliminimin e varfërisë. Në raportin e Ekspertes së Pavarur për Komisionin e të Drejtave të Njeriut [E/CN.4/2001/54, 16 shkurt 2001], ajo prezenton zbulimet themelore për mënyrën e ndryshimit të gjendjes së të varfërve. Arsimimi për të drejtat e njeriut dhe aftësimi i të varfërve, janë vendimtare për plotësimin e këtyre kërkesave dhe për t'ju ndihmuar atyre ta ndryshojnë ardhmërinë e tyre. Procesi i arsimimit në të drejtat e njeriut promovon dhe avancoon analizimin kritik të të varfërve për të përballuar të gjitha llojet e situatave dhe realitetin. Pra, ky proces ofron njohuri konkrete, aftësi dhe kapacitete për t'i përballur forcat që i mbajnë ata të varfër. Arsimimi mbi të drejtat e njeriut e bën të mundur krijimin e organizatave dhe themelimin e rrjeteve për vetëndihmë, në mënyrë që ato të kërkojnë dhe vazhdojnë përparimin drejt realizimit të të gjitha drejtave të njeriut në drejtim të çrrënjësjes së plotë të varfërisë.

ZHVILLIMI DHE ÇRRËNJOSJA E VARFËRISË

QËLLIMI: *deri në vitin 2015, të përgjysmohet përqindja e popullatës botërore, që ka të ardhura më pak se një dollar në ditë dhe të përgjysmohet përqindja e popullsisë që vuan nga uria.*

Strategjitë për Zhvillim

VARFËRIA NË TË ARDHURA

- Sigurimi i përkrahjes për shtetet dhe iniciativat ekonomike e shoqërore, të cilat përqendrohen në uljen e varrërisë;
- Forcimi i aftësive për të ofruar shërbimeve elementare shoqërore;
- Asistimi në ndërtimin e kapaciteteve për vlerësimin, monitorimin dhe planifikimin e varfërisë.

URIA

- Ndërmarrja e veprimeve plotësuese nga ato të bëra në Samitin Botëror të Ushqimit në vitin 1996, si dhe propozimi i planeve të reja në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për realizimin e qëllimeve lidhur me urinë;
- Garantimi i ushqimit, tregtisë bujqësore dhe politikave të përgjithshme të afarizmit, përmes vendosjes së një sistemi afarsit të drejtë dhe të barabartë, për të ofruar siguri ushqimore për të gjithë.
- Vazhdimi i përqendrimit të prioritetit ndaj farmerëve të vegjël dhe përkrahjen e përpjekjeve të tyre për përmirësimin e vetëdijes lidhur me mjedisin dhe teknologjitë e thjeshta, e të lira për prodhim.

BURIMI: ROAD MAP TOWARDS THE IMPLEMENTATION OF THE UNITED NATIONS MILLENIUM GOALS. REPORT OF THE SECRETARY-GENERAL, 6 SEPTEMBER 2001.

E DOBISHME TË DIHET

Në bazë të përvojës së lëvizjeve popullore, punës së OJQ-ve dhe organizatave të tjera humanitare, është krijuar një koncensus i përgjithshëm, se për t'iu siguruar të varfërve qasja në beneficione dhe zhvillim, ku është e domosdoshme të ndërmerren disa veprime

elementare siç janë, reformat tokësore, pronësore, kontrollimi i të mirave dhe resurseve nga të varfërit, arsimimi dhe zhdukja e analfabetizmin, si veprime në fushën e shëndetësisë, strehimit dhe ushqyeshmërisë. Ofrimi i lopëve hibride në vend të tokës atyre që nuk kanë tokë, ose dhënia e kredive për blerjen e tokës, pa trajtuar edhe nevojat e tjera të infrastrukturës siç është rasti kur bagëtitë varen nga irigacioni, si dhe ofrimi i shkollimit plotësues në vend të shkollimit të plotë për fëmijët e punëtorëve, janë qasje të cilat nuk kanë funksionuar! Këto vetëm sa e kanë vazhduar varfërinë. Problemet kryesore janë, vullneti politik dhe redistribuimi ose shpërndarja.

Çrrënjosja e efektive e varfërisë është treguar e suksesshme atëherë kur është ndërmarrë në nivelin e decentralizuar lokal. Ajo është e suksesshme vetëm atëherë kur të varfërit bëhen subjekte pjesëmarrëse dhe jo vetëm objekte të proceseve zhvillimore, pasi që në këtë mënyrë bëhet i mundshëm zhvillimi njerëzor i barabartë.

Mësimet e përbashkëta dhe të veçanta të nxjerra nga përvojat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e uljes të varfërisë

- Varfëria është po aq problem social, kulturor dhe politik, sa është edhe problem ekonomik.
- Aftësimi politik dhe ekonomik i të varfërve, janë mjete për çrrënjosjen e varfërisë.
- Qasja e atyre që janë lënë anash në informata dhe arsimim për të drejtat e njeriut, u mundëson të vetëdijësohen për të drejtat e tyre dhe të marrin veprime për ndryshim e gjendjes së tyre.
- Sigurimi i punës me pagë të mjaftueshme për jetesë dhe qasja në resurset prodhuese, janë kyçe për uljen e varfërisë.
- Ulja e varfërisë do duhej të shoqërohet me zvogëlimin e padrejtësive. Prioritetet duhet fokusuar në eliminimin e gjitha formave të diskriminimit kundër guas, si dhe diskriminimit të bazuar në kastë, racë ose etnicitet (kombësi).
- Sa më të mëdha në shpenzimet në arsim, shëndetësi, strehim, ujë, higjienë publike dhe furnizim me ushqime të mjaftueshme, më e vogël do të jetë varfëria.
- Shteti me ministritë e tij kanë rol të rëndësishëm në uljen e varfërisë, sidomos në kohën e globalizimit.

- Përgjegjësia më e lartë e institucioneve ndërkombëtare dhe vendore financiare, nënkupton sigurimin e drejtë dhe të barabartë të zhvillimit ekonomik.
- Shumë shtete në botë nuk janë në gjendje të zhdukin varfërinë në mënyrë imediate. Përpjekjet e tyre duhet të përkrahen dhe plotësohen me ndihmën dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.
- Falja e borxheve është e lidhur drejtpërdrejt me uljen e varfërisë. Nëse borxhet e falura kanë qenë të lidhura me investimet në arsim, shëndetësi dhe sektorë të tjerë shoqëror, kjo do të kontribuojë drejtpërdrejt për uljen e borxheve.
- Lufta dhe konfliktet e shtojnë varfërinë. Përpjekjet për çrrënjosjen e varfërisë pa sigurimin e kushteve të paqes dhe sigurisë së vërtetë, janë të gjykuara për dështim.



1. PRAKTIKA TË MIRA

Të varfërit janë profitabilë

Banka Grameen ka filluar punën në vitin 1976 në Jorba-Bangladesh, si një shoqëri e vogël aksionare fshatare. Deri në vitin 2002, ajo ka përfshirë 2.4 milion huamarrës, prej të cilëve, 95% janë gra. Me 1175 degë, ajo ofron shërbime në 41.000 fshatra, duke përfshirë më shumë se 60% të gjitha fshatrave të Bangladeshit.

Grameen Banka tenton, që kryesisht përmes akumulimit të kapitalit lokal dhe krijimit të pasurisë, të bëjë mobilizimin dhe avancimin e të varfërve. Qëllimi i saj është zgjerimi i shërbimeve bankare për të varfërit e viseve rurale të Bangladeshit, eliminimi i eksploatimit nga huadhënësit e parave, krijimi i mundësive të vetëpunësimit për resurset e pashfrytëzura njerëzore dhe atyre pak të shfrytëzuara, bashkimin e njerëzve me të meta nën ombrellë organizative të cilën ata e kuptojnë dhe në të cilën mund të veprojnë me vetëbesim dhe ku përmes përkrahjes së ndërsjellë veprojnë për zhvillimin e tyre shoqëror-ekonomik.

Duke u përqendruar në atë grup të njerëzve të cilët janë konsideruar si rreziku më i madh për kredi, kjo bankë ka vërtetuar se të varfërit janë të vlefshëm për kredi. Kjo bankë trajton barrën e dyfishtë, si atë të gjinisë, ashtu edhe varfërinë me të cilën përballen femrat. Banka Grameen, ka pasur sukses në iniciimin e ndryshimeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me sistemin e pronësisë së mjeteve, produkteve dhe kushtet e prodhimit në

viset rurale. Këto ndryshime janë të rëndësishme jo vetëm për lëvizjen e të varfërve përtej kufirit të varfërisë, por gjithashtu për atë se në fshatra përkrahja e tillë ka nxitur një sasi të lartë të kreativitetit. Veprime të ngjashme si Banka Grameen gjithashtu janë ndërmarrë edhe në disa shtete tjera.

<http://www.grameen-info.org/bank>

Iniciativa e Malit 20 -20

Pas mbajtjes së Samitit Botëror Social në Kopenhagë më 1995, Mali miratoi iniciativën e njohur si 20 – 20, e cila nënkupton se afër 20% e shpenzimeve të buxhetit të përgjithshëm dhe 20% e ndihmave ndërkombëtare për një vend, do të përdoren për finansimin e shërbimeve elementare të asaj shoqërie. Gjithashtu, që nga viti 1995, muaji tetor është shpallur „*Muaj i Solidaritetit dhe Luftës kundër Përrjashtimit*“.

Punimet Strategjike për Uljen e Varfërisë (PRSP)

Me **Iniciativën e Shteteve të Varfëra me Borxhe të Larta (HIPC)** më 1999, është arritur pajtimi që t’ju paraqiten Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar të gjitha strategjitë kombëtare për uljen e varfërisë përmes bazave të huazimit të koncesioneve dhe lirit nga borxhet. Kjo qasje reflektohet me zhvillimin e PRSP-ve nga autoritetet shtetërore. Deri në janar të vitit 2003, trembëdhjetë shtete të Afrikës (në mesin e të cilave edhe Mali), katër shtete të Amerikës Latine, dy shtete të Evropës dhe Azisë Qendrore, një shtet Aziatik dhe një shtet i Lindjes së Mesme, i kanë paraqitur Bordeve të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar PRSP-të e tyre.

Të gjitha PRSP-të janë përgatitur duke i marrë parasysh pesë parimet themelore që nënvizojnë zhvillimin dhe implementimin e strategjive për uljen e varfërisë:

- udhëheqja nga shteti – përfshirja e pjesëmarrjes së gjerë të shoqërisë civile dhe sektorit privat në të gjitha nivelet e operacionalizimit;
- orientimi në rezultate – përqendrimi në rezultate që do t’iu sjellë dobi të varfërve;
- njohja gjithpërfshirëse e natyrës multidimensionale të varfërisë;
- orientimi në partneritet – përfshirja e pjesëmarrjes së koordinuar të partnerëve të zhvillimit (bilateral, multilateral dhe joqeveritar);
- perspektiva afatgjatë e orientuar në uljen e varfërisë.

Grupe të ndryshme të shoqërisë civile kanë kritikuar PRSP-të për ekzistimin e disa të metave elementare siç është varësia e lartë e strukturës së tyre financiare nga ndihmat e jashtme dhe promovimi i investimeve të huaja të drejtpërdrejta. Pjesëmarrja e të të prekurve vendor dhe në veçanti pjesëmarrja e grupeve të rrezikuara mbetet një pikëpyetje, pasi që shpesh mungojnë mekanizmat institucionale për përfshirjen e tyre të vërtetë në këto procese dhe paraqiten pengesa siç janë, mungesa e informatave dhe dokumenteve të ofruara në gjuhët lokale të cilat ata i kuptojnë. Këto, si dhe kufizimet e tjera duhen trajtuar edhe më tutje, dhe për një kohë më të gjatë.

BURIMI:

[HTTP://WWW.WORLDBANK.ORG/POVERTY/STRATEGIES/OVERVIEW.HTM](http://www.worldbank.org/poverty/strategies/overview.htm)

Uji ynë nuk është për shitje

Këshilli Kanadez është një organizatë e përhershme mbikëqyrëse e qytetarëve kanadezë, i cili përfshinë më se 100.000 anëtarë dhe 70 degë lokale nga i gjithë vendi. Ky këshill, me qëllim të vënies së disa problemeve shtetërore në qendër të vëmendjes, siç janë: sigurimi i programeve shoqërore, promovimi i drejtësisë ekonomike, përtëritja e demokracisë, mbrojtja e sovranitetit kanadez, përparimi i alternativave të tregtisë së lirë nga stili i kompanive dhe ruajtja e mjedisit, duke u bazuar në karakterin e fortë jopolitik të cilin e ka, lobon te deputetët e parlamentit, zhvillon hulumtime dhe organizon fushata kombëtare.

Këshilli, në fillim të vitit 1999 filloi një fushatë të suksesshme për mbrojtjen e kanadezëve dhe mjedisit të tyre nga efektet e eksportit të lartë të ujit dhe efektet e privaizimit. Kjo fushatë e ka zanafillën në besimin se uji paraqet një burim publik, i cili u takon të gjithëve dhe të cilin askush nuk ka të drejtë ta përvetësojë, ose të përfitojë nga ai. Duke vërejtur interesat vetjake të kompanive dhe investitorëve, të cilit liqenet e pastra, lumenjtë dhe shtresat ujëmbajtëse të Kanadasë, i shohin si rezervuarë të pasura për shfrytëzim, kjo fushatë mobilizoi opininon dhe veprimtarinë publike kundër privatizimit dhe komercializimit të këtij burimi që nuk ka çmim.

Në shkurt të vitit 2002, gjatë Forumit Social Botëror në Porto Alegre të Brazilit, Këshilli Kanadez së bashku me një numër të organizatave nga vendet e ndryshme, duke parë rritjen e kundërshtimit ndaj privatizimit dhe vjedhjes së ujit nga kompanitë në mbarë botën dhe duke dashur të shndërrojnë këtë kundërshtim në një vizion të ri për të ardhmen e planetit, lansoi Marrëveshjen Globale për Ujin. Ky propozim është prezantuar në Samitin Botëror për Zhvillim të Qëndrueshëm, në Afrikën Jugore, në gusht të vitit 2002. Puna e Këshillit është zgjeruar edhe në shërbimet e tjera bamirëse siç janë, shëndeti, arsimi, si dhe tregtia dhe çështjet e investimit. <http://www.canadians.org>

Një e ardhme e qëndrueshme

Shembulli i holandezëve për vlerësimin e shkallës dhe ndikimit të “*gjurmëve të tyre ekologjike*” në sektorët kryesorë, përfshirë energjetikën dhe bujqësinë, si dhe përkushtimi i tyre që brenda periudhës së caktuar kohore ta ulin ndikimit negativ të gjurmëve të tyre, është një shembull pozitiv i një shteti të industrializuar në vlerësimet e dëmit ndaj mjedisit nga ana e qeverisë. Gjithashtu, ky shtet i raporton në baza të rregullta Komisionit të OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm, lidhur me progresin e bërë, së bashku me raportet mbi implementimin e Agjendës 21.

Liria nga Uria

Organizata **Para së gjithash Ushqimi**, është e vendosur në Kaliforni të SHBA-ve dhe përkushtohet për të eliminuar padrejtësitë të cilat shkaktojnë urinë. Ata besojnë së të gjithë njerëzit kanë të drejtën elementare për ta ushqyer veten dhe se ata duhet ta kenë kontrollin e vërtetë demokratik mbi burimet e domosdoshme për ta ushqyer veten dhe familjet e tyre. Organizata, duke bërë hulumtime dhe analiza, përmes arimit, përkrahjes së rrëzimit të miteve dhe ekspozimit të shkaqeve të vërteta, pasataj përmes identifikimit të pengesave që duhen ndryshuar dhe shqyrtimit të mënyrave për largimin e tyre, si dhe përmes vlerësimit dhe publikimit të alternativave të suksesshme, punon për vetëdijësimin e popullit për mundësitë dhe fuqinë e tyre për të bërë ndryshime. <http://www.foodfirst.org>

Drejtësia Ekonomike

Koalicioni për Lirinë nga Borxhet (FDC), është i vendosur në Filipine dhe punon për zhvillimin njerëzor: barazi (duke përfshirë barazinë gjinore), për të drejtat ekonomike dhe drejtësinë; zhvillimin e barabartë dhe të qëndrueshëm; bënë presion ndaj qeverive për t'i kryer obligimet e tyre, si dhe lufton për krijimin e marrëdhënieve globale ekonomike dhe përfituese ndërmjet kombeve të ndryshme. FDC-ja, përkrah fushatën botërore për faljen e borxheve shteteve më të varfëra në botë. Koalicioni ka trajtuar edhe një varg çështjesh të tjera, përfshirë sigurinë ushqimore, shpenzimet publike dhe ndikimin e politikave ekonomike në mesin e grave. Puna e tyre në fushën e avokatisë integron në vete arsimimin e popullit, informimin e publikut, mobilizimin masiv, hulumtimin dhe analizën e politikave, ndërtimin e aleancave si dhe të rrjeteve provinciale.

<http://www.freedomfromdebtcoalition.org>

Marrëveshja e Kotonous

Marrëveshja e Partneritetit, e lidhur mes ACP-së dhe Komunitetit Evropian në Kotonou (Cotonou) më 23 qershor 2000, vë interes të posaçëm mbi **sigurinë ushqimore**. Neni 54, trajton ekskluzivisht sigurinë ushqimore dhe pranon rolin e rëndësishëm të cilin siguria ushqimore e luan për garantimin e sigurisë dhe mirëqenies njerëzore. Gjithashtu, kjo marrëveshje shpjegon përpunimin e hollësishëm të prioriteve për zhvillimin e politikave ndihmëse të BE në raport me avancimin e sigurisë njerëzore.

2. TRENDET



Gjatë Mbledhjes së Mileniumit të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në vitin 2000, udhëheqësit e shteteve dhe qeverive, e pranuan përgjegjësinë e tyre kolektive në mbështetjen e parimeve të dinjitetit njerëzor, barazisë dhe drejtësisë në nivel global. Ata përcakuan **tetë synime për zhvillimin dhe çrrënjosjen e varfërisë**, të cilat duhet të realizohen deri në vitin 2015, dhe të cilat përfshijnë: çrrënjosjen e varfërisë dhe të urisë ekstreme, realizimin universal të arsimimit fillor, promovimin e barazisë gjinore, aftësimin e grave, uljen e vdekshmërisë të fëmijët, përmirësimin e shëndetit mental, sigurimin e qëndrueshmërisë së mjedisit dhe krijimin e partneritetit global për zhvillim. Dekada 1996-2006, është deklaruar si **Dekada e Parë e OKB-së për Çrrënjosjen e**

Varfërisë. Çdo vit, **17 tetori** konsiderohet si **Ditë Ndërkombëtare për Çrrënjosjen e Varfërisë.**

Një numër i madh i shteteve kanë bërë një progres të konsiderueshëm në këtë drejtim, mirëpo shtetet e tjera, kryesisht ato më të varfërat, duket se nuk mund t'i plotësojnë këto synime. Edhe pse, 55 shtete me 23% të popullsisë botërore, janë në rrugë të mirë për t'i realizuar së paku $\frac{3}{4}$ e synimeve, 33 shtete me 26% të popullsisë botërore, janë duke dështuar në realizimin e më shumë se gjysmës së synimeve. Do të nevojiten përpjeke të jashtëzakonshme në pjesën e poshtme të Saharës së Afrikës. Më shumë se 60% e popullsisë botërore në 55 shtete, nuk janë në rrugë të mirë për të realizuar synimin për uljen e vdekshmërisë të fëmijët. Duke u nisur nga përshtypjet e tepruara mbi përmasat e shteteve që janë duke bërë përpjime, shtetet të cilave u mungojnë shënimet, mund të kenë performansa më të këqija.

3. KRONOLOGJIA

Liria nga varfëria – dispozitat kryesore në instrumentet ndërkombëtare

1948: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (Nenet 22, 23, 25, 26).

1961: Karta Sociale Evropiane, e monitoruar nga Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

1965: Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (Neni 5, e monitoruar nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor).

1966: Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (Nenet 6, 7, 9, 11, 12, 13, e monitoruar nga Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore)

1979: Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave ndaj Diskriminimit të Grave (Nenet 10, 11, 12, 13, 14, e monitoruar nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave).

1981: Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve (Nenet 14 – 17, 20 – 22, e monitoruar nga Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve).

1988: Protokoli Shtesë i San Salvadorit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut, i monitoruar nga Komisioni Interamerikan për të Drejtat e Njeriut.

1989: Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Neni 27, e monitoruar nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijës).

AKTIVITETE TË PËRZGJEDHURA



1 **AKTIVITETI I: “BOTA NË NJË FSHAT”**

PJESA I: HYRJE

Ushtrimi ka të bëjë më padrejtësitë dhe deprivimin e përjetuar nga të varfërit në kontekst të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Forma e aktivitetit: Ushtrim

PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR USHTRIMIN

Qëllimet dhe Synimet

Sensibilizimi i të rinjve për çështjet e pabarazisë në shpërndarjen e pasurisë dhe resurseve. Ky ushtrimi i ndihmon të rinjtë të mendojnë për statusin e tyre në relacion me varfërinë dhe të mendojnë për realizimin e të drejtave të tyre. Po ashtu, ky ushtrim u jep atyre rast që të kuptojnë nevojat urgjente për ndryshimin e pabarazive dhe padrejtësive të cilat i përjetojnë të varfërit dhe për caktimin e prioriteteve me qëllim të sigurimit të zhvillimit për të gjithë.

Grupi i synuar: fëmijët dhe të rinjtë

Madhësia e grupit/organizimi shoqëror: 20 – 25 njerëz

Kohëzgjatja: 90 minuta

Përgatitja: Të fotokopjohet numër i mjaftueshëm i materialit për aktivitetin, për të gjithë pjesëmarrësit e ushtrimit

Materiali: Fotokopje të fletëve punuese (të bashkangjitura), lapsa me ngjyrë/markerë.

Aftësitë e përfshira: aftësi analitike, aftësi për diskutim dhe aftësi reflektive.

PJESA III. INFORMATA SPECIFIKE PËR USHTRIMIN

Ky ushtrim është pranuar nga Planprogrami për Edukim në Media, i zhvilluar nga Abhivykati në Indi. <http://www.abhivykati.org.in>

Përshkrimi i aktivitetit/ Instruksionet: Para se të fillohet, ua shpërndaj pjesëmarrësve fletat punuese. Pastaj, deri sa je duke i lexuar instruksionet, kërko nga pjesëmarrësit që t'i zbatojnë ato.

I. Kërko nga pjesëmarrësi të imagjinojnë se e gjithë bota (6000 milionë) është mbledhur në një fshat përfaqësues, i cili përbëhet vetëm nga dhjetë banorë.

1. Në rendin e parë rrumbullakëso një figurë e cila juve ju paraqet si personin më të pasur në botë (rrumbullakëso figurën e parë) në rendin në të cilin renditen nga më pasurit deri te personi më i varfër i botës (personi i dhjetë).

2. 50 % e popullsisë botërore (pra pesë fshatarë) nuk do të ushqehen mjaft, do të jenë të uritur ose do të vdesin nga uria. Kryqo pesë pjatat e fundit në rendin e dytë.

3. Tetë persona do të jetojnë me standarde shumë të ulëta (pra 80% e popullsisë botërore). Këtu përfshihen lagjet me të varfër, të pastrehët, të zhvendosurit dhe refugjatët. Pra, largo tetë shtëpitë e fundit nga rendi i tretë.

4. Shtatë persona nuk do të kenë aftësi për të lexuar, pra 70% e gjithë të gjithë njerëzve të botës nuk do të mund të lexojnë. Vër shenjat mbi shtatë librat e fundit në rendit e katërt.


5. Njëri person posedon 60% të pasurisë botërore, duke i lënë kështu nëntë personat e tjerë të ndajnë 40% e pasurisë së mbetur. Kryqëzo gjashtë grumbujt e parë të parave në rendin e pestë dhe shëno afër personit të parë nga rendi i parë një 6-she të madhe.

6. Vetëm një përqind e njerëzve të botës posedojnë kompjuter (një e dhjeta e kompjuterit të parë sipas kësaj shkalle). Në rendin e gjashtë, njeriut të parë në kompjuter ngjyrosja hundën me ngjyrë të kuqe.

7. Një për qind e popullsisë së botës ka qasje në arsimim të lartë. Vizato një rrumbullak rreth xhufkës së të diplomuarit në rendin e shtatë, duke treguar vetëm një të dhjetën e kësaj figure.

8. Shikoje këtë listë edhe një herë, për të parë nëse dëshiron ta shqyrtosh edhe një herë rezultatin. Nëse ndryshon diçka, vizato dy rrahë rreth vlerësimit tënd të ri.

II. Dhe tani kërko nga pjesëmarrësit të dëgjojnë këto përfundime:



- nëse keni ushqim për ta ngrënë shujtën e ardhshme në shtëpi, nëse keni rroba, kulm mbi kokë dhe vend për të fjetur, atëherë ju jeni ndër tre njerëzit më të pasur në botë.
- Nëse ju (ose prindërit tuaj në qoftë se jeni të mitur) keni para në bankë, disa i keni në portofolin tuaj dhe disa të holla tjera në një enë në shtëpi, atëherë ju kualifikoheni të jeni personi më i pasur sipas kësaj shkalle të vlerësimit.

III. Varësisht nga profili i pjesëmarrësve, tregoni statistikat e fundit të marra nga raporti i fundit mbi Zhvillimin Njerëzor të UNDP dhe/ose nga Raporti për Zhvillimin Botëror të Banës Botërore lidhur me atë shtet ose grup të shteteve për fushën e arsimit, shëndetësisë, ujit, higjienës, shpenzimeve ushtarake etj.,.

Vlerësimi

Grupi do të përkrahet që të diskutojë dhe të shprehën mendimin lidhur me statistikat e ndryshme të paraqitura para tyre. Ushtrimi mund të hulumtojë:

- Kundërthëniet që dalin nga shënimet.
- Të hulumtojë nëse realiteti i pjesëmarrësve është ose nuk është i ngjashëm me statistikat.
- Lidhmërinë e ketëyre shënimeve me realizimin ose shkeljen e të drejtave të ndryshme të njeriut në raport me varfërinë.
- Synimet dhe prioritetet që ata do të donin t'i vinin për zhvillim, dhe arsyet për këtë.

Këshilla praktike: Deri sa pjesëmarrësit janë duke e bërë ushtrimin individualisht, i inkurajo ata që të shkëmbejnë mendimet e tyre me të tjerët. Roli i moderatorit është të ofrojnë informata dhe të moderojnë diskutimin.

PJESA IV: VAZHDIMI

Pjesëmarrësit mund të inkurajohen, që, duke u bazuar në këtë ushtrim, të bëjnë plane për zhvillimin e aktivitete të lidhura me arsimimin për të drejtat e njeriut me bashkëmoshatarët e tyre.



AKTIVITETI II: FUSHATA PËR VEPRIM

PJESA 1: HYRJE

Ky aktivitet ka për qëllim zhvillimin e një fushate për veprim lidhur me një problem lokal të ndërlidhur me varfëri. Natyra e përhapjes së gjerë të varfërisë duket si gjithëpërfshirëse dhe njerëzit mund të ndiejnë se nuk kanë asnjë ndikim dhe rol në çrrënjosjen e saj.

PJESA II. INFORMATA TË PËRGJITHSHME MBI QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT

- Vetëdijësimi dhe ngritja e menjëhershme e ndieshmërisë për varfërinë te pjesëmarrësit.
- Zhvillimi i marrëdhënieve mes manifestimeve të menjëhershme të varfërisë dhe shkaqeve të saj në tërësi.
- Identifikimi i veprimeve - çka mund të bëjë pjesëmarrësi në një situatë konkrete të varfërisë.

Grupi i synuar: të rriturit/ të rriturit e rinj

Madhësia e grupit: 20 njerëz, ose më pak , grupe të përbëra nga 4-5 anëtarë

Kohëzgjatja: 150 minuta

Përgatitja: Tabela, marker, ngjyra, pastel, penë, letër për poster dhe fotografi të njerëzve që jetojnë në varfëri. Shkarko nga interneti raste për studim, që përmbajnë shkelje të ndryshme, duke u bazuar në disa web-faqe të propozuara në pjesën e Praktikave të mira të këtij moduli. Si shembull mund të merren qeveritë, të cilat kompanive multinationale u

japin të drejtën për privatizimin e shërbimeve themelore, ose u japin të drejta mbi pyjet dhe liqenet për peshkim afarist. Zgjidh disa citate nga të varfërit për gjendjen e tyre personale nga “*Voices of the Poor*” (Zërat e të Varfërve), <http://www.worldbank.org>, ose nga ndonjë burim tjetër informativ.

Aftësitë e përfshira: Aftësi analitike, aftësi artikuluese, identifikimi ose vënia e vetes në lëkurën e të varfërit.

PJESA III. INFORMATA SPECIFIKE MBI PARAQITJEN E VEPRIMTARISË

- Fillo duke lexuar disa nga citatet e zgjedhura që reflektojnë zërat e të varfërve në raste të ndryshme.
- Inkurajo pjesëmarrësit të përmendin individë/grupe/ose komunitetet nga jeta e tyre e përditshme, të cilët jetojnë në varfëri absolute ose relative dhe të atyre që përballen me përjashtim nga shoqëria. Sipas një koncensusi, i lejo grupet të identifikojnë rastet me të cilat do të dëshironin të punojnë gjatë vazhdimin të ushtrimit.
- Vullnetari i cili do të raportojë për rastin konkret të varfërisë do ta marrë rolin e të varfërit, deri sa anëtarët e tjerë të gupit, duke pasur parasysh dimensionet e ndryshme (sociale/politike/ekonomike/kulturore/mjedisit) të jetës së atij personi/komuniteti, do të tentojnë të bisedojnë me të.

Pastaj, anëtarët e grupit numërojnë çështjet dhe dimensionet e varfërisë, shkaqet imediate dhe strukturore të varfërisë, si dhe identifikojnë kush dhe çka ndikon në këto raste. Të gjitha këto, grupi duhet t’i ndërlidhë me nenet e përshtatshme të konventave për të drejtat e njeriut.

Pastaj, kërko nga grupi të bëjë fushatë për zhvillimin e arsimimit në të drejtat e njeriut, me qëllim të trajtimit të problemeve me të cilat përballlet grupi dhe të propozojnë veprime frytdhënëse afatshkurta dhe afatgjata. Pas gjithë kësaj, grupi mund të përgatisë një pamflet/poster/ose çfarëdo forme tjetër të materialit për zhvillimin e fushatës, me qëllim që pjesën e mbetur të grupit ta bindin për t’iu bashkangjitur fushatës.

Vlerësimi

Grupi i cili ka ka bërë prezentimin tenton t'i bindë të tjerët pët t'iu bashkangjitur fushatës. Pjesëmarrësit e tjerë kanë mundësi të kërkojnë sqarime ose informata lidhur me rëndësinë që ata t'i bashkangjiten fushatës. Ushtrimi ofron mundësinë reale për shqyrtimin e miteve, keqformulimeve dhe paragjykimeve. Moderatorit shfrytëzon rastin për t'i bërë të njohura problemet e varfërinë dhe globalizmit, për të përmbledhur njohuritë mbi raportet mikro-makro të varfërisë dhe për të inkurajuar idetë kreative për vazhdimin e mëtejshëm.

PJESA IV. VAZHDIMI

Shikoni një film i cili trajton ndonjë fushatë në një çështje të caktuar të varfërisë ose aranzho një vizitë në terren në ndonjë OJQ e cila punon me komunitete të vogla. Inkurajo anëtarët të ndërlidhen me ndonjë OJQ ose fushatë lokale e cila prek jetën e tyre.

BIBLIOGRAFIA

Focus on the Global South. 2001. *Profiting from Poverty: The ADB Private Sector and Development in Asia.* Focus on the Global South, Thailand.

Haq, Mahub-ul. 1995. *Reflections on Human Development.* New York: Oxford University Press.

Harris, John. 1994. *Poverty and Anti-Poverty Policy: A Perspective for SCF in the South Asian Region.* Saro Briefing Paper No.2. Save the Children.

International Human Rights Internship Programme, Asian Forum for Human Rights and Development. 2000. *Circle of Rights: Economic Social and Cultural Rights Activism: A Training Resource.*

Khan, Azizur Rahman and Carl Riskin. 2001. *Inequality and Poverty in China in the Age of Globalization.* New York: Oxford University Press.

Nayyar, Rohini. 1992. *Rural Poverty in India – An Analysis of Inter-State Differences.* Oxford University Press, India.

People's Decade for Human Rights Education. 2002. *Passport Dignity.*

People's Movement for Human Rights Education (PDHRE). *A Call for Justice: Resource Packet*.

Pernia, Ernesto M. 1999. *Urban Poverty in Asia: A Survey of Critical Issues*. Oxford University Press, China.

Subramanian, S. 1998. *Measurement of Poverty and Inequality*. Oxford University Press, India.

United Nations Development Programme. 1997. *Human Development Report 1997*. Oxford University Press.

United Nations Development Programme. 1998. *Training Manual on Human Rights and Sustainable Human Development*. UNDP, New York.

United Nations Development Programme. 2002. *Human Development Report 2002: Deepening Democracy in a Fragmented World*. Oxford University Press.

SAARC, 1992. *Report of the Independent South Asian Commission on Poverty Alleviation: Meeting the Challenge*.

Sainath, Palagummi. 1996. *Everybody Loves A Good Drought*. Penguin Books.

Watkins, Kevin. 1995. *The Oxfam Poverty Report*. Oxfam UK & Ireland.

Yanus, Muhhamed et al. 1999. *Banker to the Poor: Micro-Lending and the Battle against World Poverty*. Public Affairs.

INFORMATATA PLOTËSUESE

50 Years Is Enough: <http://www.50years.org>

Child Rights: <http://www.unicef.org/crc>

Combat Poverty Agency: <http://www.cpa.ie>

Commission on Human Rights: <http://www.unhcr.ch>

Development Gateway: <http://www.developmentgateway.org>

Division for the Advancement of Women:

<http://www.un.org/womenwatch/daw/beijing/platform/poverty>

ELDIS: <http://www.ids.ac.uk/eldis/poverty>

Eliminating World Poverty and Making Globalization Work for the Poor:

<http://www.globalization.gov.uk>

Focus on the Global South: <http://www.focusweb.org>

Friends of River Narmanda: <http://www.narmada.org>

International Monetary Fund: <http://www.imf.org>

Jubileesouth: <http://www.jubileesouth.org>

Lothian Anti Poverty Alliance: <http://www.lapa.org.uk>

Our World is Not For Sale: <http://www.ourworldisnotforsale.org>

PovertyNet: <http://www.povnet.org>

Sub-Commission on the Promotion and Protection for Human Rights:

<http://www.unhcr.ch/html/menu2/2/sc.htm>

United Nations Development Programme (UNDP): <http://www.undp.org>

World Bank: <http://www.worldbank.org/poverty>